



**Tribuna Channel**  
**Besiana Hoti**  
**Drejtoreshë**  
**Prishtinë**

**Rasti Nr. 2018/194**  
**Ref:1902/130/KPM/mf**

### VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2018/194 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për  
Tribuna Channel (Palë Përgjegjëse)**

---

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 22 dhjetor 2017 ka miratuar Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale me të cilën janë përcaktuar parimet themelore të komunikimeve komerciale audiovizuale gjatë emetimit të tyre nga ofruesit e shërbimeve mediale, duke përfshirë përmbajtjen, çështjet etike dhe kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale audiovizuale.
2. KPM me datat 17, 19 dhe 21 nëntor 2018 ka bërë monitorimin e programeve të transmetuara nga Pala Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2017/07. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 4 dhjetor 2018 është gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2017/07.
3. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 21 janar 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2017/07. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.
4. KPM brenda afatit të paraparë nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Pala Përgjegjëse.

#### Analiza Ligjore

5. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 10, paragrafi 1, dhe nenit 11, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2017/07.

Neni 10, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2017/07, përcakton se:

*“Reklamimi televiziv dhe teleshopingu duhet të jenë lehtësisht të dallueshme dhe të veçueshme nga përmbajtja editoriale. Pa paragjykim ndaj shfrytëzimit të teknikave të reja të reklamimit, reklamimi televiziv dhe teleshopingu duhet të mbahen të dallueshme nga pjesët tjera të programit me anë të mjeteve pamore apo/edhe dëgjimore dhe/ose hapësinore.”*

Komisioni në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk e ka bërë dallimin e komunikimeve komerciale dhe teleshopingu nga pjesët tjera të programit me anë të mjeteve pamore dhe dëgjimore, siç përcaktohet në Rregulloren KPM-2017/07.

6. Zyra Ekzekutive gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 11, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07.

Neni 11, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2017/07, përcakton se:

*“Kohëzgjatja e spoteve të reklamimit televiziv dhe spoteve të teleshopingu për transmetuesit televiziv komercial brenda një ore të caktuar, me përjashtim të kanaleve televizive ekskluzivisht të përkushtuar ndaj reklamimit dhe teleshopingu si dhe kanaleve televizive ekskluzivisht të përkushtuar ndaj vetë-promovimit, nuk mund të jetë më e gjatë sesa dymbëdhjetë(12) minuta.”*

Zyra Ekzekutive në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Tribuna Channel ka tejkaluar kohëzgjatjen e lejuar të komunikimeve komerciale audiovizuele prej 12 minutash brenda një ore transmetimi. Me datën 17 nëntor 2018 Tribuna Channel ka transmetuar 22 minuta e 38 sekonda komunikime komerciale brenda orës 09:00-10:00; 24 minuta e 28 sekonda brenda orës 10:00-11:00 dhe 19 minuta e 43 sekonda brenda orës 13:00-14:00. Me datën 19 nëntor 2018 Tribuna Channel ka transmetuar 16 minuta e 10 sekonda komunikime komerciale brenda orës 07:00-08:00; 16 minuta e 40 sekonda brenda orës 10:00-11:00; 17 minuta e 55 sekonda brenda orës 11:00-12:00; 17 minuta 29 sekonda brenda orës 14:00-15:00 dhe 16 minuta brenda orës 16:00-17:00. Me datën 21 nëntor 2019 Tribuna Channel ka transmetuar 18 minuta e 52 sekonda komunikime komerciale brenda orës 10:00-11:00; 18 minuta brenda orës 11:00-12:00 dhe 33 minuta e 45 sekonda brenda orës 16:00-17:00, duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07.

7. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, dhe nenit 11, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07.

### **Vendim**

1. Komisioni i KPM-së gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 10, paragrafi 1, dhe nenit 11, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07.

